



RAPORT
MBI PJESËMARRJEN E
PUBLIKUT DHE TË SHOQËRISË
CIVILE
NË PROCESIN VENDIMMARRËS
TË KUVENDIT
PËR VITIN 2023

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Metodologjia	4
Akronime.....	6
Kreu I	7
Veprimtaria e komisioneve dhe e nënkomisioneve parlamentare.....	7
Kreu II	21
Shqyrtimi i projektligjit të buxhetit të shtetit dhe i projektligjeve financiare	21
Kreu III.....	24
Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian	24
Kreu IV.....	27
4.1 Koordinimi me shoqërinë civile.....	27
Kreu V	32
Organizime vullnetare në kuvend	32
Kreu VI.....	38
Pjesëmarrja e publikut.....	38
Sfidat për të ardhmen:	41
Aneksi I	44
Projektligje në cilësinë e komisionit përgjegjës.....	44
Aneksi II.....	49
Projektligjet e konsultuara me shoqërinë civile	49
Aneksi III	50
Projektligjet e konsultuara në Platformën <i>on-line</i>	50
Aneksi IV	52
Institucionet dhe oshc-të	52
Aneksi V.....	55
Të dhënat e faqes zyrtare parlament.al.....	55
Bibliografia	75

Hyrje

Parlamenti është institucioni qendror i demokracisë. Ai ka një mandat unik për të përfaqësuar popullin, për të miratuar ligje, për të miratuar buxhetin dhe për të kërkuar llogari nga qeveria. Vendimet e marra nga parlamenti formojnë të ardhmen e shoqërisë, madje përcaktojnë edhe “fatin” e gjeneratave që do të vijnë.

Prandaj, mënyra në të cilën parlamentet i kryejnë funksionet e tyre është e një rëndësie të madhe. Ndërsa pritshmëritë e publikut evoluojnë, parlamentet sfidohen të jenë gjithnjë e më efektivë, të përgjegjshëm dhe transparentë. Njerëzit duan dhe kanë nevojë, që proceset e vendimmarrjes të jenë gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese. Hapësira qytetare pasqyron kushtet, të cilat lejojnë shoqërinë civile dhe individët të organizohen, të komunikojnë dhe të marrin pjesë në jetën publike pa kufizime të dukshme ose diskriminim (Keutgen dhe Dodsworth 2020; OECD 2022). Një shoqëri civile, e gjallë, është e rëndësishme dhe gur themeli i demokracisë, pasi përmirëson kulturën e përgjegjshmërisë dhe transparencës, forcon efektivitetin dhe reagimin e qeverisë dhe rrit besimin e publikut në qeveri (Sharma 2008; OECD 2022). Kur ka hapësirë për veprim qytetar, proceset e qeverisjes së një vendi shpesh karakterizohen nga parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes publike në vendimmarrje (Kombet e Bashkuara 2020).

Sikundër, OSHC-të kanë një rol të rëndësishëm në formësimin e politikave dhe ligjeve dhe në promovimin e nevojave të qytetarëve në procesin e ligjvënies. E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe politikbërje, është një nga parimet themelore demokratike, i cili siguron që njerëzit të mund të trajtojnë problemet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Gjithashtu, pjesëmarrja e qytetarëve u mundëson autoriteteve të kryejnë kompetencat e tyre në mënyrë më efikase. Shpesh, është sfiduese për qytetarët që të kontaktojnë individualisht me vendimmarrësit dhe të kenë një ndikim të drejtpërdrejt e të prekshëm në proces. Prandaj, OSHC-të përgjithësisht, shihen si një “*gate keeper*- urë lidhëse”, ndërmjet qytetarëve dhe Parlamentit dhe, që i ndihmojnë ata në artikullimin më konstruktiv të mendimit.

Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut dhe shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe ligjeve është njohur globalisht. Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare është forcimi i dialogut në dobi të cilësisë së demokracisë me përmbajtje dhe pikëpamje të propozuara nga strukturat e shoqërisë. Rrjedhimisht, shoqëria civile duhet të jetë në gjendje të diktojë procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes me sugjerime, mendime dhe ide. Andaj, duhet të garantohet e drejta e shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes politike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është një forum i rëndësishëm për përfaqësimin e shoqërisë civile. Parlamenti ka zhvilluar dhe zhvillon në vijëmbësi mekanizma për dialog të hapur, objektiv dhe transparent me organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që të trajtojë boshllëqet e krijuara në një shoqëri demokratike si e jona. Shoqëria civile luan një rol kyç dhe zë një hapësirë të rëndësishme të veprimtarisë parlamentare, me qëllim që të sigurojë, që deputetët të jenë të vetëdijshëm për vlerën dhe rëndësinë që ka pjesëmarrja e individit qytetar dhe shoqërisë civile, në mënyrë kuptimplote dhe gjithëpërfshirëse në proceset demokratike. Organizatat e Shoqërisë Civile mund të angazhohen në Kuvend, pikërisht për të mbrojtur dhe forcuar hapësirën qytetare, edhe pse

në disa kontekste, mund të jetë sfiduese ky angazhim, për vetë faktin, se deputetët janë politikanë, me mendime dhe interesa të ndryshme politike, për atë çka përfaqësojnë.

Kështu, referuar praktikës sonë parlamentare, konsultimi publik është një formë pjesëmarrjeje, përmes së cilës, Kuvendi fton publikun më të gjerë (OSHC-të, individët e interesuar, grupet e interesuara) të japë mendime, komente, pikëpamje dhe opinione ligjore për një projektligj të caktuar.

Metodologjia

Ky raport pasqyron veprimtarinë parlamentare të Kuvendit, për përmbushjen e një prej misioneve të tij të rëndësishme, siç është procesi i transparencës në funksion të rritjes së bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile, përmes informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi mbi baza institucionale.

Për hartimin e këtij raporti, janë përdorur analiza hulumtuese, të dhënat statistikore, pasqyrimi skematik në mënyrë grafike dhe tabelare i këtyre të dhënave, të gjeneruara nga shërbimet e Kuvendit dhe, veçanërisht Shërbimi i Komisioneve, i cili është edhe struktura përgjegjëse.

Sa i përket metodologjisë, raporti është hartuar duke përdorur teknikat e analizës së punës në grup, vështrimin krahasimor dhe zgjedhjen e modeleve më të përshtatshme, referuar praktikave të parlamenteve evropiane, si dhe konsultimin e projektraportit të hartuar nga Shërbimi i Komisioneve, me shërbimet e tjera të Kuvendit, Sekretariatit për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit, në funksion të përmirësimit të cilësisë së këtij raporti, në kuadër të procesit të bashkërendimit dhe koordinimit institucional.

Në këtë raport, pasqyrohet bashkëpunimi i institucionit të Kuvendit me publikun, shoqërinë civile, me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet publike. Ai është strukturuar i ndarë në shtatë krerë, si më poshtë vijon:

Kreu I trajton veprimtarinë e komisioneve dhe të nënkomisioneve parlamentare, si dhe bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen me organizatat e shoqërisë civile.

Kreu II trajton shqyrtimin e projektligjit të buxhetit të shtetit dhe projektligjeve të tjera financiare, ashtu sikundër përcaktohet në aktet rregullatore të Kuvendit.

Kreu III pasqyron rolin gjithëpërfshirës të Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian dhe bashkëpunimin e tij me organizatat e shoqërisë civile.

Kreu IV trajton koordinimin me shoqërinë civile në kuadër të transparencës parlamentare.

Kreu V informon për veprimtarinë dhe aktivitetet e organizimeve/grupimeve vullnetare në Kuvend.

Kreu VI pasqyron pjesëmarrjen e publikut në seancat plenare, vizitat dhe synon të bëjë transparente veprimtarinë e Kuvendit.

Kreu VII trajton sfidat për të ardhmen dhe angazhimin e Kuvendit në kuadër të përmirësimit të bashkëpunimit me publikun.

Në përfundim, në raport një vend të posaçëm zë edhe angazhimi në vijim i institucionit të Kuvendit për përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, grupet e interesit dhe grupimet e interesuara dhe sfidat, me të cilat përballet ky institucion.

Akronime

AGD -	Aleanca e Grave Deputete
OJF-	Organizata jofitimprurëse
OSHC-	Organizata të shoqërisë civile
GDMF -	Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”
KÇLAPDNJ -	Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KEF -	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
KÇE -	Komisioni për Çështjet Evropiane
KPJ -	Komisioni për Politikën e Jashtme
KSK -	Komisioni për Sigurinë Kombëtare
KVPTM -	Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
KÇSSH -	Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
KEMIP -	Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
KKIE-	Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian
OZHQ –	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
AZHQ -	Agjencia për Zhvillim të Qëndrueshëm
FB –	Facebook
Publiku –	Në kuptim të pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve, personave të interesuar dhe përfaqësuesve të institucioneve publike

KREU I

VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE DHE NËNKOMISIONEVE PARLAMENTARE

1.1. Komisionet e përhershme parlamentare/nënkomisionet

Komisionet parlamentare janë organe të Kuvendit të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Komisionet parlamentare shqyrtojnë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive, të institucioneve dhe organeve të tjera qendrore dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje dhe projektrezoluta.

Kuvendi ka në përbërjen e tij 8 komisione të përhershme parlamentare¹:

1. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;
2. Komisioni për Integrimin Evropian;
3. Komisioni për Politikën e Jashtme;
4. Komisioni për Ekonominë dhe Financat;
5. Komisioni për Sigurinë Kombëtare;
6. Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin;
7. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë;
8. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Kuvendi ka ngritur edhe 6 nënkomisione parlamentare² për çështje të vecanta, që lidhen me veprimtarinë e komisionit të përhershëm dhe funksionojnë në përbërje të tyre:

1. Nënkomisioni Për të Drejtat e Njeriut³;
2. Nënkomisioni Për Administratën Publike⁴;
3. Nënkomisioni Për Diasporën dhe Migracionin⁵;
4. Nënkomisioni Për Qeverisjen Vendore⁶;
5. Nënkomisioni Për Zhvillim të Qëndrueshëm⁷;
6. Nënkomisioni Për Mjedisin dhe Bujqësinë⁸.

1.2. Përbërja e komisioneve parlamentare

Kuvendi në Legjislaturën X (janar–dhjetor 2023) përbëhet nga 140 deputetë, nga të cilët 50 janë gra dhe 90 burra.

¹ Neni 19 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

² Neni 19 pika 2 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

³ Kuvendi me Vendim nr. 39/2022

⁴ Kuvendi me Vendim nr. 40/2022

⁵ Kuvendi me Vendim nr. 41/2022

⁶ Kuvendi me Vendim nr. 38/2022

⁷ Kuvendi me Vendim nr. 34/2022


⁸ Kuvendi me Vendimi Nr. 80/2022

Me zgjedhjen e znj. Lindita Nikolla në krye të Kuvendit, numri i grave të zgjedhura në postin e Kryetarit të Kuvendit përgjatë të gjitha legjislativave shkon në 2, nga 9 që është numri i përgjithshëm i kryetarëve të Kuvendit ndër vite.

Kryetarët e 8 komisioneve të përhershme parlamentare janë 5 gra dhe 3 burra.


Përbërja politike në komisionet e përhershme parlamentare është sipas grafikut nr.1, si më poshtë:

Grafiku nr.1




Përbërja gjinore e komisioneve të përhershme është sipas grafikut nr.2, si më poshtë:

Grafiku nr.2




Përbërja politike në nënkomisionet parlamentare është sipas grafikut nr.3, si më poshtë vijon:

Grafiku nr.3



Përbërja gjinore e anëtarëve të nënkomisioneve është sipas grafikut nr.4, si më poshtë:

Grafiku nr.4




1.3. Veprimtaria e komisioneve parlamentare

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, komisionet e përhershme parlamentare kanë pasur një veprimtari parlamentare dinamike e produktive, brenda fushës së përgjegjesisë së tyre. Më konkretisht, komisionet parlamentare e kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre në zbatim të Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit, akteve rregullatore të tjera dhe legjislacionit në fuqi. Mbledhjet e komisioneve janë zhvilluar të hapura, si për shqyrtimin e projektligjeve, ashtu dhe për seancat dëgjimore.

Mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe organeve të tjera të Kuvendit, u zhvilluan në disa muaj të vitit 2023, *online*, me anë të mjetit Cisco – Webex të instaluar në Kuvend⁹.

Në periudhën janar–dhjetor 2023 janë zhvilluar 347 mbledhje, të cilat pasqyrohen në grafikun nr.5, si vijon:


Grafiku nr.5



Numri i seancave dëgjimore në komisione ka qenë 101 të tilla, respektivisht: 37 seanca dëgjimore për procesin legjislativ, 49 për mbikëqyrjen dhe kontrollin, 13 për funksionin zgjedhës dhe 2 për çështje të tjera, të pasqyruara sipas grafikut nr.6 si më poshtë vijon:

⁹ Vendimi nr.17, datë 1.11.2023, i Konferencës së Kryetarëve


Grafiku nr.6



Komisionet e përhershme parlamentare në veprimtarinë e tyre kanë ftuar të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me opinionet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre organizata të ndryshme të shoqërisë civile, organizata dhe misione ndërkombëtare, institucione të pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, si dhe grupe të ndryshme interesi.


Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar 576 amendamente në total të propozuara nga deputetët, nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit. Gjatë shqyrtimit, 499 prej tyre janë miratuar, nga të cilat 455 të deputetëve dhe 44 të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, të pasqyruar në grafikun nr.7, si më poshtë vijon:

Grafiku nr.7



Sa i përket amendamenteve të deputetëve të miratuara dhe amendamenteve të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit të miratuara për çdo komision, ato janë të pasqyruara në grafikun nr.8, si vijon:

Grafiku nr.8



Garantimi i procesit të punës së Kuvendit, në mënyrë efikse, transparente dhe bashkëpunuese ka qenë dhe mbetet një ndër prioritet e Kuvendit.

Tabela më poshtë, reflekton në mënyrë më të detajuar veprimtarinë parlamentare për çdo komision parlamentar gjatë vitit 2023, si më poshtë vijon:

Tabela nr.1

Procesi Punës Komisioni	Numri i mbledhjeve	Projektligje	Pyetje të deputetëve për projektligje	Amendamente të propozuara nga deputetë	Amendamente të propozuara nga publiku/oshc	Amendamente të miratuara në Komisione të deputetëve	Amendamente të miratuara në Komisione të publiku/oshc	Organizata të shoqërisë civile dhe Grupe Interesi (GI)	Seanca dëgjimore	Projektrezoluta	Raporte të Organeve Kushtetuese apo të krijuara me ligj në Komisione
KÇLAPDNJ	68	121	685	148	26	142	3	0	24	15	17
KÇE	17	27	137	30	0	30	0	0	4	0	0
KPJ	32	41	75	0	0	0	0	0	8	0	0
KEF	62	77	544	153	60	137	28	12	12	6	6
KSK	29	19	163	15	0	15	0	7	13	0	3
KVPTM	45	51	286	88	9	88	9	12	12	3	3
KÇSSH	45	11	188	43	33	36	4	23	7	0	0
KEMIP	49	11	216	8	0	7	0	12	21	2	2

Përfaqësimi gjinor

Kuvendi është i angazhuar për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe të 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe indikatorëve të tyre, sipas fushave të veprimtarisë jetësore, ku vend të rëndësishëm zë edhe Objektivi nr.5 “Barazia gjinore – arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave”, konkretisht, miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislacionit detyrues për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

Kështu, Kuvendi e ka vlerësuar të rëndësishëm përfaqësimin gjinor dhe e ka përfshirë atë si komponent në disa prej statistikave të veprimtarisë parlamentare, duke vënë në dukje se cila pjesë e popullsisë është më aktive në këto veprimtari. Duke ju referuar të dhënave të gjeneruara nga komisionet, vërehet se në mbledhjet e komisioneve kanë marrë pjesë 1850 pjesëmarrës, nga të cilët 960 gra dhe 890 burra, ashtu sikundër pasqyrohet në grafikun nr.8, si vijon:

Grafiku nr. 8



1.4. Veprimtaria për çdo komision

- **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KÇLAPDNJ)**

Fusha e përgjegjësisë së Komisionit është shqyrtimi i çështjeve që kanë lidhje me kodet, organizimin e pushtetit gjyqësor, administratën publike, administratën e pushtetit gjyqësor, organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut. KÇLAPDNJ-ja ka zhvilluar 68 mbledhje, nga këto 24 kanë qenë seanca dëgjimore, nga të cilat 17 në proces kontrollues, 5 në proces zgjedhës dhe 2 për çështje të tjera.

Në Komision janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në seanca dëgjimore 610 përfaqësues të institucioneve publike dhe qendrore. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 319 gra dhe 291 burra.


Lidhur me paraqitjen e amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara në komision, të tilla janë 174, të ndara në:

- 148 amendamente të deputetëve, ku 142 prej tyre janë pranuar;
- 26 amendamente të shoqërisë civile, ku 3 prej tyre janë pranuar.

Pra, komisioni ka miratuar në total 145 amendamente, nga të cilat 142 të propozuara nga deputetët dhe 3 të propozuara nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.9), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 9: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



KÇLAPDNJ ka në përbërjen e tij 3 (tre) nënkomisione:

- Nënkomisioni për Administratën Publike
- Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore
- Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Veprimtaria në nënkomisione

Nënkomisioni për Administratën Publike, si fushë të përgjegjësisë së tij ka çështjet, të cilat hyjnë në sferën e veprimit të legjislacionit në fuqi për administratën publike.

Ky nënkomision ka zhvilluar 1 (një) mbledhje.

Nënkomisioni ka zhvilluar 1 (një) seancë dëgjimore me Departamentin e Administratës Publike (DAP) në ushtrimin e kontrollit parlamentar, ku është shqyrtuar progresraporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2022.

Gjatë ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, në nënkomision janë bërë gjithsej 13 pyetje.

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, si fushë të përgjegjësisë së tij ka të drejtat e njeriut dhe ka zhvilluar 1 (një) mbledhje, konkretisht seancë dëgjimore me kandidatët për anëtarë, përfaqësues të Shqipërisë pranë Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT) në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

- **Komisioni për Çështjet Evropiane (KÇE)^{10 11}**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në vend, luan një rol kyç në procesin e integrimit evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të tij. Kuvendi ka përmirësuar dukshëm funksionimin e strukturave nëpërmjet të cilave ushtron përgjegjësitë e tij në procesin e integrimit evropian siç janë: Komisioni i për Çështjet Evropiane (Komisioni) dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE). Gjatë vitit 2023, roli i Kuvendit në çështjet e integrimit evropian është forcuar më tej. Komisioni i për Çështjet Evropiane (KÇE) dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) kanë luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

Komisioni për Çështjet Evropiane, për vitin 2023, bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” i ndryshuar (ligji 15/2015), ka ushtruar kompetencat e tij në funksionin legjislativ, kontrollues dhe zgjedhës.

KÇE ka zhvilluar 17 mbledhje, nga këto 4 seanca dëgjimore në proces kontrollues.

Në Komision janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në seanca dëgjimore 96 përfaqësues të institucioneve publike dhe qendrore. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 58 gra dhe 38 burra.


Për projektligjet e shqyrtuara në këtë komision janë paraqitur dhe miratuar 30 amendamente të deputetëve.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.10), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

¹⁰ Emri i Komisionit për Integritimin Evropian është ndryshuar me ligjin nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, i ndryshuar”

¹¹ Komisioni për Çështjet Evropiane tashmë në kuadër të përmirësimit të funksionimit të strukturave nëpërmjet të cilave ushtron përgjegjësitë e tij në procesin e integrimit evropian është pjesë e Shërbimit të Integritimit Evropian.

Grafiku 10: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



- **Komisioni për Politikën e Jashtme (KPJ)**


Fusha e përgjegjësisë së komisionit është shqyrtimi i çështjeve për politikën e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

Komisioni për Politikën e Jashtme ka zhvilluar 32 mbledhje, nga të cilat 8 seanca dëgjimore në proces kontrollues.

Në Komision janë ftuar dhe kanë marrë pjesë 207 përfaqësues të institucioneve qendrore dhe kandidatura. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 107 gra dhe 100 burra.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.11), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 11: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



Komisioni për Politikën e Jashtme ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin (NDM), fusha e përgjegjësisë së të cilit është shqyrtimi i çështjeve të diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.

Veprimtaria e punës së nënkomisionit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, është realizuar me organizimin e një numri total prej 2 (dy) mbledhjesh. Numri i seancave dëgjimore të zhvilluara nga nënkomisioni është 2 (dy) seanca dëgjimore në procesin e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare:

- seancë dëgjimore për veprimtarinë vjetore, për vitin 2022 të Agjensisë Kombëtare të Diasporës dhe seancë dëgjimore për veprimtarinë vjetore, për vitin 2022 të Qendrës së Botimeve për Diasporën;
- seancë dëgjimore për veprimtarinë vjetore, për vitin 2022 të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, për përgatitjen e akteve nënligjore në lidhje me votën e diasporës.

• **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (KEF)**

Fusha e përgjegjësisë së komisionit është shqyrtimi i çështjeve të politikave ekonomike, buxheti i shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemi banker, si dhe çështjet e Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve që rrjedhin prej saj.

Komisioni ka zhvilluar 62 mbledhje gjithsej, nga të cilat 12 seanca dëgjimore, respektivisht: 8 në procesin legjislativ dhe 4 në procesin zgjedhës.

Në kuadër të bashkëpunimit i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje 522 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të grupeve të interesit dhe të institucioneve publike. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 265 gra dhe 257 burra.


Lidhur me paraqitjen e amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara në komision, të tilla janë 206 amendamentete, të ndara në:

- 153 amendamente të deputetëve, ku 137 prej tyre janë pranuar;
- 60 amendamente të shoqërisë civile, ku 28 prej tyre janë pranuar.

Komisioni ka miratuar 165 amendamente, nga të cilat 137 të propozuara nga deputetët dhe 28 të propozuara nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.12), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 12: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili ka si fushë të përgjegjësisë zhvillimin ekonomik dhe social, rritjen ekonomike të qëndrueshme, realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendës 2030, të Kombeve të Bashkuara.

Brenda fushës së tij të përgjegjësive, nënkomisioni ka zhvilluar 2 (dy) mbledhje. Gjithashtu, nënkomisioni ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në funksion të procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit ndaj këtij institucioni, për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

- **Komisioni për Sigurinë Kombëtare (KSK)**


Fusha e përgjegjësive së Komisionit është organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete. Komisioni ka zhvilluar 29 mbledhje gjithsej, nga të cilat 13 seanca dëgjimore, respektivisht: 7 në procesin legjislativ dhe 6 në procesin kontrollues.

Në kuadër të bashkëpunimit, i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore 76 përfaqësues të institucioneve publike. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 27 gra dhe 49 burra.

Lidhur me paraqitjen e amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara në komision, janë 15 amendamente të propozuara nga deputetët, të cilat komisioni i ka miratuar.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.13), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 13: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



- **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (KVPTM)**

Fusha e përgjegjësive së komisionit është shqyrtimi i çështjeve të bujqësisë, industrisë, telekomunikacioneve, turizmit, rregullimit të territorit, tregtisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Komisioni ka zhvilluar 45 mbledhje gjithsej, nga të cilat 12 seanca dëgjimore, respektivisht: 6 në procesin legjislativ, 3 në procesin kontrollues dhe 3 në procesin zgjedhës.

Në kuadër të bashkëpunimit, i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje 145 përfaqësues të institucioneve publike. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 65 gra dhe 80 burra.


Lidhur me paraqitjen e amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara në komision, të tilla janë 97, të ndara në:

- 88 amendamente të deputetëve, të pranuar;
- 9 amendamente të shoqërisë civile, të pranuar.

Pra, komisioni ka miratuar në total 97 amendamente, nga të cilat 88 të propozuara nga deputetët dhe 9 të propozuara nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.14), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 14: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka në përbërjen e tij Nënkomisionin për Mjedisin dhe Bujqësinë. Nënkomisioni ka si fushë të përgjegjësisë çështjet e mjedisit dhe bujqësisë.

- ***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (KÇSSH)***

Fusha e përgjegjësisë së komisionit është shqyrtimi i çështjeve për marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia.

KÇSSH ka zhvilluar 45 mbledhje gjithsej, nga të cilat 7 seanca dëgjimore, respektivisht: 5 seanca dëgjimore në procesin legjislativ dhe 2 në procesin kontrollues.

Në kuadër të bashkëpunimit i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje 157 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të grupeve të interesit dhe të institucioneve publike. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 110 gra dhe 47 burra.


Lidhur me paraqitjen e amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara në komision, të tilla janë 76, të ndara në:

- 43 amendamente të deputetëve, ku 36 prej tyre të pranuar;
- 33 amendamente të shoqërisë civile, ku 4 prej tyre të pranuar.

Pra, komisioni ka miratuar në total 40 amendamente, nga të cilat 36 të propozuara nga deputetët dhe 4 të propozuara nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.15), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 15: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



- **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (KEMIP)**

Fusha e përgjegjesisë së Komisionit është arsimi në çdo nivel, kultura rinia, shkenca, sportet, media e shkruar dhe vizive.


Komisioni ka zhvilluar 49 mbledhje gjithsej, nga të cilat 21 seanca dëgjimore, respektivisht: 11 në procesin legjislativ, 9 seanca dëgjimore në procesin kontrollues dhe 1 në proces zgjedhës.

Në kuadër të bashkëpunimit i janë përgjigjur thirrjes për pjesëmarrje në seanca dëgjimore 37 përfaqësues të institucioneve publike e qendrore dhe të shoqërisë civile. Në aspektin gjinor pjesëmarrja e tyre ka qenë 9 gra dhe 28 burra.

Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komision janë shqyrtuar 8 amendamente të propozuara nga deputetët, ku janë miratuar 7 prej tyre.

Siç vërehet edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.16), në një vështrim krahasimor, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në këtë komision, është si më poshtë:

Grafiku 16: Numri i seancave dëgjimore në proces legjislativ, mbikëqyrës e kontrollues dhe zgjedhës, ndër vite



KREU II

Shqyrtimi i projektligjit të buxhetit të shtetit dhe i projektligjeve financiare¹²

Në zbatim të Rregullores së Kuvendit, Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit, komisionet e përhershme, sipas fushave që mbulojnë, organizojnë punën për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Komisionet e Përhershme Parlamentare, gjatë vitit 2023 kanë organizuar seanca dëgjimore publike me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve nga institucione, persona ose grupe të interesuara për projektligjin e Buxhetit të Shtetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Shqyrtimi i projektligjit për buxhetin e shtetit dhe projektligjeve financiare për vitin 2024 në komisionet e përhershme parlamentare

Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit në komisione janë propozuar 81 amendamente, prej të cilave 51 janë miratuar; 9 janë miratuar pjesërisht dhe 19 nuk janë miratuar.

KÇLAPDNJ ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:

- diskutime në parim: 1 mbledhje
- diskutime nen për nen: 6 mbledhje
- seanca dëgjimore: 22 gjithsej

KÇE ka zhvilluar gjithsej 3 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit.

Komisioni, pasi ka shqyrtuar shpërndarjen buxhetore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA dhe dokumentat politik të Bashkimit Evropian si Raporti i Progresit të Komisionit Evropian ka konstatuar se projektligji ka parashikuar përmbushjen e këtyre detyrimeve.

KPJ ka zhvilluar gjithsej 2 mbledhje për shqyrtimin e buxhetit, si vijon:

- diskutime në parim: 1 mbledhje
- diskutime nen për nen: 1 mbledhje

KEF ka zhvilluar gjithsej 11 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:

- diskutime në parim: 9 mbledhje
- seanca dëgjimore në parim : 4
- diskutime nen për nen: 2 mbledhje

KSK ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:

- diskutime në parim: 1 mbledhje
- diskutim nen për nen: 1
- seanca dëgjimore: 6

¹² Rregullorja e brendshme e Kuvendit, neni 79.

KVPTM ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:

- diskutime në parim: 5 mbledhje
- diskutime nen për nen: 1 mbledhje

KPÇSSH ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:


- diskutime në parim: 3 mbledhje (3 ministrinë përkatëse)
- seanca dëgjimore: 1 mbledhje
- diskutimi nen për nen: 1 mbledhje

KEMIP ka zhvilluar gjithsej 8 mbledhje për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit si më poshtë:

- diskutime në parim: 7 mbledhje
- seanca dëgjimore në parim: 8 seanca
- diskutimi nen për nen: 1 mbledhje


Në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.17), pasqyrohen numri i amendamenteve për çdo komision, që ka shqyrtuar projektligjin e buxhetit dhe projektligjet financiare, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, si vijon:

Grafiku nr.17



Në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.18), pasqyrohen numri gjithsej i amendamenteve për çdo komision, që ka shqyrtuar projektligjin e buxhetit dhe projektligjet financiare, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, si vijon:

Grafiku nr.18



Kreu III

KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EVROPIAN

3.1 Shoqëria civile në Këshillin Kombëtar të Integrimit Evropian

KKIE është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës për çështjet e integrimit. KKIE është gjithashtu një mekanizëm institucional i konsultimit të çështjeve të integrimit evropian me të gjithë aktorët e interesuar, në të cilin shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian është i angazhuar që përfshirja e shoqërisë civile të vijë duke u forcuar nëpërmjet diskutimit të vazhdueshëm për politikën që lidhen me detyrimet e anëtarësimit.

Në vijim të ndryshimit të ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar, më datë 26.05.2023, në faqen elektronike të Kuvendit u publikuan 3 thirrjet për rinovimin e anëtarësimit në Këshillin Kombëtar të Integrimit Evropian, përkatësisht për aplikimin e OSHC-ve, përfaqësuesve të medias dhe organizatave të biznesit, dhomave të tregtisë dhe sindikatave. Pas përfundimit të afatit parashikuar në thirrjet respektive, datë 15.06.2023, dhe pas vlerësimit u kualifikuan:

- 16 përfaqësues nga shoqëria civile;
- 6 përfaqësues nga grupet e interesit;
- 3 përfaqësues nga media.

KKIE, duke vlerësuar ekspertizën dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile në çështjet e integrimit evropian, ka organizuar në bashkëpunim me OSHC-të dhe grupet e tjera të interesit 8 veprimtari ndërgjegjësuese si më poshtë:

- roli që luan Kuvendi i Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave – AIEN;
- sesioni plenar i Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian 2021- 2023, në bashkëpunim me European Movement Albania (EMA) dhe Slovak Foreign Policy Association;
- roli që luajnë OSHC-ët dhe grupet e interesit si pjesë e KKIE në procesin e integrimit evropian, në bashkëpunim me Akademinë e Konsumatorit;
- procesi i negociatave me Bashkimin Evropian me grupe interesi të ardhur nga Gjermania;
- procesi i integrimit evropian, roli i Kuvendit dhe KKIE në procesin e integrimit, në bashkëpunim me Institutin Parlamentar, me studentë dhe pedagogë nga Univeristeti i Danimarkës;
- procesi i negociatave, roli i Kuvendit dhe KKIE në procesin e integrimit, në bashkëpunim me Institutin Parlamentar, KAS dhe me grupe interesi të ardhur nga Franca;
- procesi i integrimit evropian dhe roli i KKIE, risitë e ndryshimeve të ligjit 15/2015 si dhe statusit aktual referuar procesit të shqyrtimit analitik, në bashkëpunim me EU Policy Hub, në Korçë;
- roli i Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian në procesin e integrimit evropian, si dhe risitë e ndryshimit të ligjit nr.15/2015 të ndryshuar, në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave – AIEN.

3.2. Shkolla e Integrimit Evropian

Rritja e kapaciteteve për çështjet e integrimit evropian, konsiderohet sfidë e gjithë shoqërisë dhe kërkon profesionistë të aftë për t'u ballafaquar me procesin e integrimit. Tradita e suksesshme e organizimit të Shkollës së Integrimit Evropian, e krijuar ndër vite nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian vazhdoi dhe në vitin 2023. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Fondacionin Friedrich Ebert dhe Western Balkans Consulting Group, organizoi Shkollën e Integrimit Evropian në datat 6-10 Nëntor 2023.

Për të tetin vit radhazi, Shkolla e Integrimit Evropian synoi të identifikojë dhe angazhojë aktorë nga të gjitha institucionet qendrore dhe ato të pushtetit vendor, organizatat e shoqërisë civile, media, minoritetet dhe grupet e interesit, duke krijuar një grup të spikatur ekspertësh me njohuri të thella mbi procesin e integrimit evropian, të cilët mund të kontribuojnë në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Shkolla e Integrimit Evropian 2023, ofroi një kuadër të plotë teorik dhe praktik mbi zhvillimet më të fundit në BE, skenarët e mundshëm për të ardhmen e tij, sfidat dhe strategjitë e negociatave, rolin e shoqërisë civile dhe medias në proces, ecurinë e procesit të integritimit të vendit, si dhe të ardhmen e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë. Lektorë nga Komisioni Evropian, Universiteti i Selanikut, ekspertë ndërkombëtarë nga Brukseli, Gjermania dhe vendet e rajonit si Serbia dhe Mali i Zi, si dhe ekspertë kombëtarë nga institucione, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile, ndanë eksperiencën e tyre profesionale në çështjet e integrimit.

Komisioni u përball me një numër të madh aplikimesh (106), i cili duke u bazuar në një përzgjedhje transparente dhe duke marrë parasysh përfaqësimin e të gjitha grupeve të interesit dhe aktorëve të procesit të integrimit, përzgjodhi 38 pjesëmarrës, të cilët u bënë pjesë e SHIE. Për herë të parë, këtij eventit i janë bashkuar on-line edhe 12 ekspertë shqipfolës nga vendet e rajonit, të cilët janë student të Shkollës së Diplomacisë Bruksel. Konkretisht:

- 5 përfaqësues nga Organizatat e Shoqërisë Civile
- 1 përfaqësues nga bashkimet profesionale;
- 2 përfaqësues nga biznesi;
- 5 lektorë dhe kërkues shkencor;
- 17 përfaqësues nga institucionet qendrore dhe të pavarura etj;
- 2 përfaqësues nga media;
- 4 përfaqësues nga bashkitë;
- 2 përfaqësues nga grupet parlamentare;
- 12 përfaqësues nga Shkolla e Diplomacisë në Bruksel.

Konsultimi i ndryshimeve ligjore të ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Më datë 3.02.2023, Sekretariati Teknik i KKIE, ju ka dërguar elektronikisht për konsultim, projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015“Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian”, i cili ishte objekt pune i komisionit të posaçëm parlamentar ngritur me vendimin nr.66/2022, të Kuvendit. Në përfundim të procesit të konsultimit, tre OSHC dërguan komentet e tyre, të cilat ju përcollën për shqyrtim komisionit të posaçëm. Ky ishte konsultimi i dytë i realizuar nga KKIE për qëllim të ndryshimit të ligjit nr.15/2015, në vijim të një aktiviteti konsultues, të zhvilluar gjatë vitit 2022.

Në vijim, grafiku i mëposhtëm (grafiku nr.19), pasqyron numrin e organizatave të shoqërisë Civile, të angazhuara me pjesëmarrjen në KKIE, qysh prej viti 2016, si vijon:

Grafiku nr. 19: Pjesëmarrja e OSHC-ve në KKIE



DRAFT

Kreu IV

Koordinimi me shoqërinë civile¹³

Rritja e bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile përmes informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit, do të vijojë të përbëjë prioritet, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi mbi baza institucionale. Përmirësimi i mekanizmave aktuale (regjistri *online*, platforma *online* e konsultimit të projektligjeve, si dhe gjetja e mekanizmave të rinj, për sigurimin e një transparence parlamentare maksimale për komunikimin e vazhdueshëm e ndërveprimin me qytetarët, do të vijojnë të jenë çështje prioritare, me qëllim ndërtimin e marrëdhënieve funksionale me publikun e gjerë dhe konsolidimin e perceptimit të këtij publiku për një parlament të hapur e transparent.

Prioritet thelbësor përbën përmbushja në vetvete e misionit kyç të Kuvendit, që lidhet me procesin efektiv të një ligjërjeje cilësore dhe kontrollit parlamentar të fortë, duke e sjellë atë më pranë pranë qytetarëve, në funksion të konsolidimit të demokracisë, promovimit të qeverisjes së mirë, zhvillimit, mirëqenies dhe integritetit evropian të Shqipërisë

Koordinimi e bashkëpunimi në mbështetje të organizatave të publikut e shoqërisë civile, për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse, si dhe për të forcuar dialogun midis shoqërisë civile dhe insitucionit, është një proces i vazhdueshëm në zbatim të konsolidimit të transparencës parlamentare. Kjo përfshin sigurimin e qasjes së organizatave të shoqërisë civile në informacion dhe resurse, si dhe ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve në të dyja kahjet, për të forcuar bashkëpunimin institucional.

Mekanizmat aktualë, për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje janë informimi, konsultimi, dialogu dhe partneriteti, të cilët konkretisht vijnë nëpërmjet mekanizma si më poshtë:

4.1 Regjistrat si mekanizma bashkëpunimi

Regjistri elektronik i OShC¹⁴-ve

Regjistri është një instrument për identifikimin e organizatave jofitimprurese dhe shërben si mjet lidhës dhe komunikues me komisionet parlamentare. Regjistri përditësohet periodikisht në bazë të kërkesave të organizatave që shprehin vullnetin e tyre për të qenë pjesë e veprimtarisë së Kuvendit. Kanë shprehur interes 16 organizata për të qenë pjesë e regjistrit elektronik të OShC-ve. Pjesë e regjistrit janë 77 organizata të shoqërisë civile.

Regjistri elektronik i Lobistëve

Në Kuvend është krijuar regjistri për lobistët. Ai është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjesisë së komisioneve të përhershme parlamentare. Regjistri përditësohet çdo fillim legjislature bazuar në thirrjen publike që Kuvendi u drejton grupeve lobiste që janë të interesuara të bashkëpunojnë me të.

¹³ <http://www.parlament.al/struktura/1f6ca8d8-fdf4-440b-869d-05ac3d0b915d>

¹⁴ www.parlament.al/Informacion/Transparenca/1

Në periudhën janar - dhjetor 2023 kanë shprehur interes të jenë pjesë e regjistrimit të lobistëve edhe 3 organizata.

4.2 Platforma e konsultimit¹⁵


Në kuadër të funksionit ligjberës që ushtron Kuvendi, me qëllim respektimin e parimit të transparencës dhe për një Kuvend të hapur e sa më pranë qytetarit, në faqen zyrtare të Kuvendit gjendet platforma *online* e konsultimit të projektligjeve. Përveç mekanizmave të tjerë të informimit, Kuvendi ka në dispozicion platformën e konsultimit të projektligjeve dhe akteve të tjera, e cila ofron mundësinë e konsultimit *online* të tyre.

Komisionet parlamentare pas miratimit të kalendarit të punës dhe caktimit të akteve që do t'i nënshtrohen konsultimit me palët e interesuara, mund të përdorin platformën *online* për të publikuar aktet, për të cilat kërkohet mendimi dhe opinioni i publikut. Janë regjistruar dhe aktualisht janë përdorues të platformës 18 organizata, 12 individë dhe 4 lobistë. Palët e interesuara, të cilët regjistrohen në platformë, njoftohen automatikisht nëpërmjet saj për çdo projektakt, i cili publikohet për konsultim.

Në arkivën e platformës aktualisht, gjenden 18 projektligje të konsultuara dhe 13 raporte¹⁶ të institucioneve kushtetuese të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj.

Të dhënat mbi palët e interes, të regjistruar në vitin 2021, krahasimisht me vitet 2022 dhe 2023, si edhe të projektligjeve të konsultuara, janë të pasqyruara në grafikun nr.20, si vijon:

Grafiku nr.20



¹⁵ <https://konsultimi.parlament.al/>

¹⁶ 13 raporte të institucioneve kushtetuese të pavarura dhe të krijuara me ligj.

4.5. Aktivitetet e Kuvendit me shoqërinë civile

Një nga mekanizmat për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin e bashkëpunimit Kuvend – Publik është koordinatori me grupet e interesit. Roli i koordinatorit, është strukturë institucionale, i cili merret me koordinimin e marrëdhënieve dhe lehtësimin e praktikave të bashkëpunimit, ndërmjet Kuvendit dhe palëve të interesuara.

Sa më sipër dhe në kuadër të punës dhe bashkëpunimit që Kuvendi ka me publikun, koordinatori ka marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga Kuvendi dhe organizatat e shoqërisë civile për përfshirjen e publikut në proceset konsultuese dhe bashkëpunuese të ndërsjella. Pikërisht, në datat 14-15 korrik 2023, në Shkodër u zhvillua një takim me ambasadorin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Bruce Berton, Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit z.Genci Gjonçaj, stafin e Kuvendit dhe specialistët e zyrave zgjedhore të hapura nga Kuvendi në 12 qarqet e vendit. Ky takim kishte në fokus ndarjen e eksperiencave dhe sfidat në përditshmërinë e punës së specialistëve të zyrave zgjedhore. Në takim u theksua roli i domosdoshëm që kanë zyrat zgjedhore si qelizat bazë për të krijuar sinergjitë e duhura ndërmjet Kuvendit dhe zgjedhësve.

Në kuadër të transparencës parlamentare, janë zhvilluar 3 aktivitete me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së, me temë “Shoqëria civile, të rinjtë dhe parlamenti: Bashkëpunimi me Kuvendin dhe deputetët në nivelin lokal”, ku për sesionin shtator –dhjetor këto veprimtari u zhvilluan në datat 24 - 25 tetor 2023, qarku Gjirokastrë, 11-12 dhjetor 2023 në Kukës dhe 22 dhjetor 2023 në qarkun Vlorë.

Në kuadër të “Akademia e OJF-ve 2022”, me kërkesë të Qendrës Burimore të Shoqërisë Civile, Kuvendi ka pritur organizata të shoqërisë civile, të cilat i ka informuar mbi proceset e transparencës parlamentare, proceseve konsultuese dhe vendimmarrjes me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e grupeve të interesit, duke i ndihmuar dhe orientuar në formimin e drejtuesve të rinj të organizatave të shoqërisë civile për të bashkëpunuar me Kuvendin. Këto aktivitete informuese janë zhvilluar në mjedisit e Kuvendit, në datat 20 shtator dhe 18 dhjetor 2023.

Më 16 nëntor 2023, Kuvendi u përfaqësua në konferencën ndërkombëtare “Ndryshimet në hapësirën qytetare dhe qëndrueshmëria e aksionit civil”, organizuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Në konferencën, e cila synonte krijimin e një hapësirë diskutimi midis sektorit jofitimprurës, përfaqësuesve nga institucionet shtetërore, komunitetit të donatorëve në vend si dhe ekspertëve ndërkombëtarë, mbi adaptueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile dhe rëndësinë e këtij procesi për qëndrueshmërinë e sektorit dhe përballjen me sukses të sfidave në kohë ndryshimesh të hapësirës qytetare, Kuvendi pati mundësinë për të shpalosur të gjitha mekanizmat që disponon si institucion në kuadër të bashkëpunimit Kuvend-Publik.

4.6. Aktivitetet e Kryetares së Kuvendit me shoqërinë civile dhe publikun

Znj.Lindita Nikolla, Kryetare e Kuvendit, në ushtrimin e kompetencave kushtetuese, një vend të rëndësishëm i ka kushtuar dhe vijon t'i kushtojë promovimit të hapësirës qytetare, ndërveprimit dhe dialogut me *ojf*-të, vendase dhe të huaja, si dhe bashkëpunimit me organizma e institucione ndërkombëtare dhe kombëtare, në funksion të realizimit të misionit për një parlament transparent dhe të hapur për publikun.

Vitet e fundit, ndërveprimi dhe bashkëpunimi me një agjendë të përbashkët Kuvend – Publik, është një tregues pozitiv i qasjes së Kuvendit, për të promovuar transparenën dhe hapësirën e angazhimit qytetar.

Në vijim, Kryetarja e Kuvendit, ka dhënë dhe vijon të japë kontributin e saj, përmes takimeve dhe pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme, për t'i dhënë zë bashkëpunimit dhe kontributit me partnerët strategjikë të Shqipërisë, në progresin e vendit tonë drejt integritimit evropian. Ndër këto veprimtari përmendim:

- Më 12 qershor 2023, me ftesë të kryetarit të Parlamentit të Suedisë, z. Andreas Norlén, kryetarja e Kuvendit zhvilloi një vizitë zyrtare në Stokholm e cila nisi me takim me ministren për Evropën znj. Jessika Roswall, ku u shpreh mirënjohja për mbështetjen dhe vendosjen solide të Suedisë ndaj procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE si edhe bindja se kjo mbështetje do të vijojë edhe gjatë zhvillimit të negociatave.
- Më 12 qershor 2023 kryetarja e Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, u takua me Presidenten e Asamblesë Parlamentare të OSBE, znj. Margareta Cederfelt. Gjatë takimit u diskutua ndikimi që ka pasur bashkëpunimi i Shqipërisë me OSBE-në në rritjen e transparencës, modernizimin e shërbimeve parlamentare dhe krijimin e një kulture të re për përmbushjen me sukses të funksioneve të Kuvendit.
- Më 12 shtator 2023, kryetarja e Kuvendit, priti në një takim të veçantë përfaqësuesit e shoqatës së emigrantëve shqiptarë në Itali “Pranë teje” me kryetar z. Edmond Ndoj, ku u shprehu mirënjohjen për punën e palodhur dhe kontributin e tyre, për integrimin e fëmijëve shqiptarë në Itali, hapjen e shkollës në gjuhën shqipe në Romë, si edhe ndihmën për fëmijët në qarkun e Lezhës.
- Më 20 tetor 2023, kryetarja e Kuvendit, u takua me kryetaren e Senatit të Kanadasë. Në takim ishin të pranishëm zëvendëskryetari i Kuvendit z. Agron Gjekmarkaj, anëtari i grupit të miqësisë z. Eduard Ndreca dhe ambasadori i Shqipërisë në Kanada, z. Ermal Muça. Tema e takimit u fokusua mbi qëndrimet e njëjta ndaj sfidave të sigurisë e të paqes. Shqipëria shprehu mbështetjen në politikën e deryve të hapura të NATO-s ndaj demokracive evropiane, gjithashtu edhe në nismën e Kanadasë kundër burgosjes arbitrare të shtetasve të shteteve të tjera.
- Më 23 tetor 2023, kryetarja e Kuvendit, u prit në një takim nga Asistent Sekretare e Shtetit, Michele J. Sison, takim në të cilin u theksua partneriteti dhe kontributi i Shqipërisë për sigurinë, krah për krah me SHBA, për çështje të ndryshme të zhvillimeve ndërkombëtare, të OKB-së, si për mbështetjen e Ukrainës, mbështetjen e Izraelit, luftën kundër terrorizmit, sigurinë kibernetike, refugjatët iranianë dhe afganë, mbështetjen e integritimit në Ballkanin Perëndimor dhe lidhshimin e Procesit të Berlinit.
- Më 13 dhjetor 2023, Kuvendi në bashkëpunim me Fondacionin Westminster për Demokraci, organizuan forumin Kombëtar "Roli i parlamentit në proceset demokratike në Shqipëri", ku në fjalën e saj përshëndetëse, kryetarja e Kuvendit, pasi pasqyroi veprimtarinë e institucionit të përmbushjen e procesve të llogaridhënies, mbikqyrjes parlamentare, transparencës dhe

gjithëpërfshirjes, shprehu vendosmërinë se Kuvendi do të vijojë të bashkëpunojë bashkarisht me partnerët, për çështje që lidhen me parlamentin dhe demokracinë, sidomos me sinergjinë midis parlamentarizmit dhe konsolidimit të vlerave e institucioneve demokratike. Ajo solli në vëmendje të të pranishmëve, se Kuvendi, vitet e fundit ka krijuar një traditë të mirë në konsultimin e veprimtarisë ligjvënëse me qytetarët dhe grupet e interesit.

Kreu V

ORGANIZIMET VULLNETARE NË KUVEND¹⁸

Në zbatim të Rregullores së Kuvendit, deputetët mund të organizohen në grupe vullnetare parlamentare, duke deklaruar qëllimin/qëllimet që synojnë të ndjekin, grupet shoqërore që përfitojnë nga veprimtaria e grupit vullnetar, emërtimin që do të mbajë grupi dhe rregullat e funksionimit të tij. Konkretisht, për vitin 2023 kanë zhvilluar aktivitetin e tyre 5 grupe vullnetare, si vijon:

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” (GDMF), ngritur me urdhrin nr.25, datë 12.11.2021, të kryetarit të Kuvendit, është grupim parlamentar vullnetar i deputetëve dhe nuk ka natyrë politike. Ai përbëhet nga deputetë të të gjithë grupeve parlamentare që shprehin dëshirën për të kontribuar në adresimin të drejtat e fëmijëve dhe realizimin e tyre në një mënyrë efektive gjatë ushtrimit të funksioneve legjislative të Kuvendit, kontrollit parlamentar dhe gjatë diskutimit dhe miratimit të buxhetit të shtetit. Ky grupim është një vlerë e shtuar për të mbështetur dhe bashkëpunuar me të gjithë partnerët dhe grupet e shoqërisë të angazhuara dhe vetë fëmijët në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe respektimin e tyre.

GDMF përbëhet nga 50 deputetë/e dhe është i organizuar në gjashtë komitete, si më poshtë:

- Komisioni për drejtësi për të mitur;
- Komisioni për bashkëpunim me *off*-të;
- Komisioni për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve;
- Komisioni për fëmijët e vendosur në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror;
- Komisioni për buxhetim për fëmijët;
- Komisioni për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.

Më 6 tetor 2023 u zhvillua mbledhja e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, në fokus të të cilës ishte zhvillimi i seancës dëgjimore, për zbatimin e ligjit “Për Regjistrin e të dënuarve për Krime Seksuale”, ku u diskutua gjegjësisht mbi mënyrat për mbrojtjen e fëmijëve nga pedofilët apo çdo person që mund t’i shfrytëzojë seksualisht ata, si dhe u raportua nga ana e përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse shtetërore në lidhje me problematikat e hasura, situatën aktuale dhe masat që do të ndërmerren në vijë mësi prej tyre në zbatim korrekt të këtij ligji në praktikë.

Aleanca e Grave Deputete

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënëse të të gjitha grupimeve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë. Grupi parlamentar i grave në Kuvendin e Shqipërisë u themelua në vitin 1995 dhe funksionoi deri në 2005.

AGD në Legjislaturën e X përbëhet nga 50 gra deputete dhe, u konstitua më 17 qershor 2022, ku u zgjodh kryesia e Aleancës.

¹⁸ Rregullorja e Brendshme e Kuvendit, neni 40/2⁴⁶

Në vëmendje të saj është arritja e objektivit, që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor minimalisht me 40%, fuqizimi ekonomik i grave, në qytet dhe në zonat rurale, pjesëmarrje më e madhe të grave në jetën kulturore, artistike, mediatike dhe shkencore të vendit, si dhe ndërmarrja e iniciativave konkrete për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Ndër aktivitetet e kësaj aleance, të zhvilluara gjatë vitit 2023, përmendim si vijon:

- Më 8 mars 2023, Aleanca e Grave Deputete përgatiti një videomesazh për Ditën Ndërkombëtare të Grave, përmes së cilit përcolli mesazhe ndërgjegjësuese për gratë dhe vajzat.
- Më 24 mars 2023, Aleanca e Grave Deputete priti, Sekretaren e Përgjithshme të OSBE-së, znj. Helga Maria Schmid. Zonja Gjonaj theksoi se promovimi i çështjeve gjinore ka motivuar, jo vetëm për të fuqizuar gratë në politikë, por dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Sekretarja e Përgjithshme e OSBE-së vlerësoi treguesit e lartë të përfaqësimit të grave në parlamentin shqiptar dhe nënvizoi, se komunikimi ndërpartiak është mjaft thelbësor dhe se ka shumë nisma që mund të ndërmerren për gratë edhe kur punojnë përtej linjave partiake.
- Më 28 mars 2023, Aleanca e Grave Deputete mori pjesë në një takim të organizuar nga UN Women, UNPA Albania dhe UNDP, ku u prezantuan objektivat e fazës së dytë të programit “Fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, program nëpërmjet të cilit synohet monitorimi i zbatimit të ligjeve në kuadër të mbrojtjes së grave nga dhuna.
- Më 22-24 qershor 2023, kryetarja e Aleancës së Grave Deputete, znj. Merita Baku, deputetet znj. Mirela Pitushi dhe znj. Teuta Ramaj, së bashku me përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri morën pjesë në Konferencën Rajonale “Kuvendet avancojnë Barazinë Gjinore” që u zhvillua në Shkup dhe u mirëprit nga Parlamenti i Maqedonisë së Veriut. Konferenca kishte në fokus kryesisht çështjet që janë thelbësore për avancimin e barazisë gjinore në rajon, duke përfshirë arritjet dhe sfidat aktuale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve për barazinë gjinore nga parlamentet kombëtare. Promovimi i dialogut, ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi ndërmjet deputetëve nga rajoni do të ndihmojë në krijimin e një platforme për deputetet gra, edhe ato nga Shqipëria për të shkëmbyer përvojat, njohuritë dhe praktikat më të mira me homologët e tyre dhe avancojë reformat me qasje të barazisë gjinore.
- Më 30 tetor 2023, gratë deputete morën pjesë në aktivitetin ndërgjegjësuës të organizuar nën kujdesin e nënkrytares së Kuvendit, znj. Ermonela Felaj, për ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për sëmundjen e kancerit të gjirit.
- Më 13 dhjetor 2023, gratë deputete morën pjesë në aktivitetin “Jo feminicit”, të organizuar nën kujdesin e krytares së Kuvendit, me mbështetjen e UN Women dhe Reporteres së Përgjithshme të AP të KiE për dhunën ndaj grave, znj. Etilda Gjonaj. Në këtë aktivitet, i cili nisi me një videomesazh kundër dhunës ndaj gruas, morën pjesë përfaqësues të Kuvendit, qeverisë, shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Kryetarja e Kuvendit, në fjalën e saj nënvizoi nevojën e ndryshimit të vizionit në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, përmes fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave, ngushtimit të hendekut gjinor në tregje, punësim e paga, zgjerimit të përfshirjes së elementëve të edukimit kundër dhunës me bazë gjinore në nivelet e arsimit parauniversitar, etj.

Klubi Parlamentar për të Rinjtë Deputetë të Kuvendit

Misioni kryesor i Klubit Parlamentar për të Rinjtë është të ketë një grup solid deputetësh nga të gjitha partitë politike në Parlament, me qëllim lobimin dhe advokimin për promovimin dhe mbështetjen e legjislacionit dhe politikave miqësore ndaj të rinjve nga Kuvendi.

Qëllimi kryesor i këtij klubi është të kontribuojë dhe promovojë një sistem politik gjithëpërfshirës, veçanërisht për të rinjtë. Krijimi i Klubit Parlamentar për të Rinjtë me Deputetë të Rinj të Kuvendit të Shqipërisë shërben, jo vetëm për të adresuar dhe avancuar çështjet rinore në politikëbërjen kombëtare, por edhe për të ndërvepruar me aktorët e shoqërisë civile, për të advokuar për çështje thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Klubi përbëhet nga 27 deputetë nga parti të ndryshme politike.

Në vijim, Klubi Parlamentar për të Rinjtë, ka dhënë dhe vijon të japë kontributin e tij, përmes takimeve dhe pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme, për t'i dhënë zë bashkëpunimit dhe kontributit me të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile. Ndër këto veprimtari përmendim:

- Më 24-25 shkurt 2023, kryetarja e Klubit znj. Andia Ulliri mori pjesë në veprimtarinë "Leadershipi Politik i të Rinjve –Platforma Ndër-Partiake", organizuar nga WFD. Takimi u fokusua në zhvillimin e aftësive dhe aktivizimin rinor në politikë, duke përfshirë sesione të ndryshme si diskutime me të rinjtë, aftësi të komunikimit në publik, dhe konkurrim në debate.
- Më 31 mars 2023, kryetarja e Klubit znj. Andia Ulliri së bashku me deputetët znj. Erisa Xhixho dhe z. Denis Deliu morën pjesë në Forumin Vjetor Rinor të Partive Politike. Ky forum mbledhi bashkë për herë të parë mbi 100 të rinj nga partitë kryesore politike në Shqipëri. Në këtë aktivitet, deputetët ndanë mendimet e tyre, lidhur me nevojën e madhe për të pasur integritet në politikë, si dhe rolin që mund të kenë të rinjtë për të thirrur dhe nxitur aktorët për më shumë integritet.
- Më 8 qershor 2023, znj. Erisa Xhixho dhe znj. Oriola Pampuri, deputete dhe anëtare të Klubit, së bashku me znj. Romina Kuko zëvendësministre e Brendshme, morën pjesë në një vizitë shkëmbimi eksperiencash në Londër, organizuar nga WFD. Delegacioni shqiptar diskutoi mbi përvojat me partitë kryesore politike britanike në lidhje me demokracinë e brendshme të partive dhe mekanizmat e financimit dhe komunikimit me publikun. Aktiviteti përfshiu edhe një sesion takimesh me Komisionin e Zgjedhjeve të Mbretërisë së Bashkuar.
- Më 13 qershor 2023, kryetarja e Klubit znj. Andia Ulliri bashkë me anëtarë të tjerë të tij, znj. Sorina Koti, z. Lavdrim Krrashi, z. Bardhyl Kollçaku dhe znj. Ina Zhupa, morën pjesë në një tryezë të rumbullakët të mbështetur nga WFD dhe Ambasada Britanike, për të diskutuar rëndësinë e parandalimit të korrupsionit përmes funksionit legjislativ. Gjatë diskutimeve, u adresua se si deputetët e Klubit Parlamentar për të Rinj mund të kontribuojnë në përmirësimin e legjislacionit përmes vlerësimit të hapësirave për korrupsion. Në tryezë u trajtua edhe tema e Diplomacisë Parlamentare nga dy ish ministra të Jashtëm dhe anëtarë të Parlamentit.
- Më 16-17 qershor 2023, znj. Orjela Nebijaj mori pjesë në trajnimin "Të rinjtë dhe politika – platforma ndërpartiake" në qytetin e Kukësit, ku u diskutua mbi nevojat për llogaridhënie dhe transparencë brenda partive politike dhe forumeve rinore, çështje të demokracisë në Shqipëri dhe rolin e të majtës dhe të djathtës. Takimi ofroi një platformë për diskutime dhe përballjen e pikëpamjeve të ndryshme në politikë dhe për problemet e shoqërisë.

- Më 24-26 gusht 2023, znj. Sorina Koti mori pjesë në “Shkolla Verore për Integritet dhe Etikë në Partitë Politike”, e cila u zhvillua në Pogradec me mbështetjen e Akademisë së Studimeve Politike dhe WFD. Aktiviteti u fokusua në ndërtimin e njohurive, ndërgjegjësimin, lehtësimin e dialogut dhe bashkëpunimin mes përfaqësuesve të partive kryesore politike. Aktiviteti u organizua në formën e një kursi tre ditor me 20 pjesëmarrës të rinj.
- Më 2 tetor 2023, u organizua një tryezë e rrumbullakët në lidhje me kuadrin e masave të parandalimit dhe kontrollit të duhanit, me fokus tek adoleshentët dhe të rinjtë. Gjatë zhvillimit të kësaj tryeze, u diskutua për mekanizmat e kontrollit ndaj konsumimit të duhanit dhe uljen e niveleve të duhanpirjes, me fokus tek adoleshentët dhe të rinjtë. Në këtë tryezë ishin të pranishëm znj. Andia Ulliri, kryetare e Klubit, z. Bardhyl Kollçaku dhe z. Arbi Agalliu anëtarë, si edhe organizata ndërkombëtare dhe vendas, e të cilët kanë në fokus fushën e mbrojtjes së shëndetit dhe të fëmijëve.
- Më 4 tetor 2023, u organizua një takim i të rinjve të angazhuar në projektin “Të rinjtë në fokus II” dhe në grupin këshillimor rinor me deputetë të Klubit Parlamentar për të rinjtë. Takimi ishte aktiviteti i fundit i serisë së “Shtigjeve Rinore”, kushtuar rritjes së dialogut mes të rinjve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri. Deputetët dhe të rinjtë diskutuan për sigurinë, arsimin dhe median. Partnerët e RYCO-s u dhanë një dimension rajonal diskutimeve dhe njohën pjesëmarrësit me praktikën më të mira rajonale. Të rinjtë mësuuan më shumë edhe për mekanizmat e Kuvendit për ndërveprimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit dhe për aksesin në procesin ligjvënës.
- Më 8-12 tetor 2023, kryetarja e Klubit znj. Andia Ulliri bashkë me deputetët znj. Erisa Xhixho dhe z. Denis Deliu, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit morën pjesë në një vizitë në parlamentin Gjerman, të organizuar nga WFD. Me homologët gjermanë u diskutuan dhe shkëmbyen tema të rëndësishme në lidhje me legjislativën dhe politikën miqësore për të rinjtë.
- Më 27 tetor 2023, Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP OSBE) zhvilloi një vizitë zyrtare të “Rrjetit Informal të Parlamentarëve të Rinj” në Asambleenë Parlamentare të OSBE-së dhe Grupit të Deputetëve të Rinj në Kuvendin e Shqipërisë, të përfaqësuar nga znj. Andia Ulliri, kryetare e këtij grupi dhe znj. Elda Hoti. Takimi u zhvillua në mjediset e Kryesisë së Kuvendit dhe përgjatë tij u shkëmbyen ide rreth rolit dhe impaktit, që ka përfshirja e politikanëve dhe parlamentarëve të rinj në përgjigjen ndaj sfidave, me të cilat përballet demokracia dhe siguria e vendit tonë, Ballkanit Perëndimor dhe rajonit të OSBE-së në tërësi. Temat kryesore të takimit ishin roli i të rinjve për të kontribuar në një kulturë paqeje, sigurie, dialogu, drejtësie, besimi dhe pajtimi, si dhe promovimi i rolit të të rinjve në parandalimin e konflikteve, promovimi dhe përforsimi i përgjigjeve të përbashkëta ndaj sfidave që lidhen me ekonominë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndryshimet klimatike përmes fuqizimit të organizatave dhe grupeve të shoqërisë civile të udhëhequra nga të rinjtë, dhe mbështetje drejt pjesëmarrjes më të madhe të të rinjve në debate dhe proceset vendimmarrëse, etj.
- Më 24 nëntor 2023, kryetarja e Klubit znj. Andia Ulliri mori pjesë në Forumin “Sfidat e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe aksesin e balancuar në financat politike”, të organizuar nga WFD në kuadër të projektit “Forcimi i integritetit zgjedhor dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”. Gjatë takimit u diskutua mbi sfidat që hasin gratë dhe vajzat për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse, si edhe për të marrë pjesë aktive në politikë. Gjithashtu, u diskutuan hapat e përbashkëta për t’i adresuar këto barrierë, përmes ndryshimeve ligjore, fuqizimit institucional dhe ndërgjegjësimin.

- Më 28-29 nëntor 2023, me ftesë të Parlamentit Evropian, Klubi Parlamentar për të Rinjtë, kryesuar nga kryetarja e këtij klubi, znj. Andia Ulliri dhe 14 deputetë të rinj të Kuvendit zhvilluan një vizitë studimore dy ditore në Parlamentin Evropian. Objektivat kryesorë të kësaj vizite studimore ishin krijimi i hapësirës për dialog mes deputetëve të rinj, lidhja me BE-në, promovimi i zgjerimit të BE-së, fuqizimi i politikëbërësve të rinj, parashikimi i së ardhmes së përbashkët. Në fokus të takimeve të zhvilluara nga parlamentarët shqiptarë ishin diskutimet dhe shkëmbimet e ideve mbi progresin dhe sfidat që hasen në procesin e integritimit, si dhe paketën e zgjerimit me fokus në të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe reformat në vend.

Grupi i Gjellbër

Me iniciativën e një grupi deputetësh të Kuvendit, ku bazuar në nenin 40/2 të Rregullores, është vendosur krijimi i grupimit vullnetar parlamentar “Grupi i Gjellbër”, i cili ka aktualisht 28 anëtarë që janë përfaqësues të tri grupeve parlamentare dhe një deputet i pavarur. Ky grup krijohet me qëllim rritjen e vëmendjes dhe ndjeshmërisë për çështjet e klimës në Parlament dhe shërben si platformë për informimin dhe dialogun për politikën mjedisore dhe mbështetjen e nismave për përmbushjen e angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Ngritja e “Grupit të Gjellbër” bazohet në eksperiencat më të mira parlamentare, me qëllim theksimin e nevojës për t’u fokusuar në çështjet e klimës dhe Agjendës së Gjellbër.

Në mbështetje të nenit 40/2 të Rregullores së Kuvendit, me urdhrin nr.55, datë 16.6.2022, të kryetares të Kuvendit, është miratuar ngritja e “Grupit të Gjellbër” dhe është njoftuar në seancën plenare të datës 23 qershor 2022.

Kryetar i Grupit të Gjellbër është z. Arben Pëllumbi. Ky grup përbëhet nga tre komitete, të cilat reflektojnë edhe shtyllat kryesore të Marrëveshjes së Agjendës së Gjellbër të Bashkimit Evropian, si vijon:

- Komiteti për Çështjet e Energjisë, i cili drejtohet nga deputeti z. Helidon Bushati;
- Komiteti për Mjedisin dhe Klimën, i cili drejtohet nga deputeti z. Eduard Shalsi dhe,
- Komiteti për Transportin dhe Mobilitetin, i cili drejtohet nga z. Ferdinand Xhaferraj.

Aktualisht, ky grup ka në përbërje 29 deputetë dhe është i hapur për anëtarësime të tjera.

Grupi i Gjellbër, me qëllim rritjen e vëmendjes dhe ndjeshmërisë për çështjet e klimës në parlament, shërben si një platformë për informimin dhe dialogun për politikën mjedisore dhe mbështetjen e nismave për përmbushjen e angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Në vijim të këtij misioni, Grupi i Gjellbër ka qenë aktiv në aktivitetet si më poshtë:

- Më 17 korrik 2023, anëtarët e Grupit të Gjellbër morën pjesë në një seancë informuese me temë “Transporti publik i gjellbër – politikën evropiane dhe incentivat e nevojshme në Shqipëri”, ku u njohën me mendimet e ekspertëve të fushës të cilët sollën eksperiencën dhe studimet më të mira vendase dhe të huaja, duke ofruar rekomandime konkrete për iniciativa ligjore që mund të ndërmerren nga deputetët.

- Më 21 shtator 2023, në Javën e Mobilitetit të Evropës, Grupi i Gjelbër ju bashku një aktiviteti për promovimin e lëvizjes me skutera elektrikë, si një masë për reduktimin e ndotjes së ajrit në qytetin e Tiranës. Parlamentarët në bashkëpunim me të rinjtë promovuan forma alternative dhe të zgjuara të transportit, si dhe diskutuan mbi rritjen e ndërgjegjësimit të deputetëve për përmirësimin e legjislacionit të transportit dhe sigurimin e incentivave për zhvillimin e transportit miqësor me mjedisin.
- Më 26-27 shtator 2023, deputeti i Grupit të Gjelbër dhe kryetari i Komitetit për Transportin dhe Mobilitetin, z. Ferdinand Xhaferraj mori pjesë në një seminar me anëtarë të Grupeve të Gjelbra të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Budva me temë “Marrëveshja e Gjelbër: Plani i Veprimit i Përbashkët”. Në këtë takim anëtarët e grupeve të gjelbra të rajonit punuan për hartimin e një plani veprimi të përbashkët për promovimin në një nivel rajonal të qëllimeve të Agjendës së Gjelbër.
- Më 31 tetor 2023, deputetët e Kuvendit, z. Ferdinand Xhaferraj dhe z. Alban Xhelili morën pjesë në një vizitë studimore pranë Sekretariatit të Komunitetit të Transportit në Beograd. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte prezantimi i grupeve të gjelbra parlamentare të vendeve të Ballkanit Perëndimor me punën e Sekretariatit të Komunitetit të Transportit, e mbështetur nga Bashkimi Evropian.
- Më 5 dhjetor 2023, Grupi i Gjelbër organizoi në bashkëpunim me zëvendëskryetaren e Kuvendit, znj. Ermonela Felaj në Kryesinë e Kuvendit, një veprimtari shkencore me temë "Sistemet e informacionit gjeografik (GIS) në vendimmarrje." Në këtë veprimtari morën pjesë deputetë të Kuvendit, si edhe pedagogë e studentë të degës së Gjeografisë të Universitetit të Tiranës. Pjesëmarrësit diskutuan mbi epokën digjitale dhe përdorimin e teknologjisë gjeohapësinore në vendimmarrje.

Për Popullsinë dhe Zhvillimin

Në mbështetje të nenit 40/2 të Rregullores së Kuvendit, “Organizimet vullnetare në Kuvend”, pranë Kuvendit, datë 18.07.2023 u konstituua Grupi Vullnetar “Për Popullsinë dhe Zhvillimin”. Grupi ka si qëllim të advokojë për çështje që lidhen me popullsinë dhe zhvillimin dhe më konkretisht, me shëndetin riprodhues, me çështje që lidhen me demografinë, moshimin etj. Ngritja dhe formimi i këtij grupi përkon me fillimin e censusit për popullsinë. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) në bashkëpunim me UNFPA, IPPF dhe EPF mbështesin aktivitetet e këtij grupi.

Në kuadër të qëllimit të grupit vullnetar Për Popullsinë dhe Zhvillimin, më 30 tetor 2023, grupi vullnetar zhvilloi aktivitetin me temë “Të luftosh kancerin e gjirit”. Në këtë veprimtari morën pjesë mjekë senologë, onkologë, gjinekologë, radiologë dhe të shëndetit publik, përfaqësues të shoqërisë civile dhe media. Në mbrëmje, Kuvendi u ndriçua rozë, në shenjë solidarizimi dhe vetëdijësimi mbi kancerin e gjirit.

Kreu VI

PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Veprimtaria e sektorit të Pritjes së Qytetarëve, Këshillimit Ligjor dhe Trajtimit të Letrave, Ankesave dhe Peticioneve dhe koordinatori për të Drejtën e Informimit

6.1 Qytetarët në Kuvend

Gjatë vitit 2023, problematikat e adresuara përmes ankesave, peticioneve, trajtimit të kërkesave të qytetarëve, lidhen me fushat e veprimtarisë jetësore si më poshtë vijon:

- ankesa për masën e pensionit;
- çështje pronësie;
- kërkesa për punësim;
- konflikte familjare;
- dëmshpërblimet për ish të përndjekurit politikë;
- mendime dhe opinione të ndryshme për situatën në vend;
- kërkesë për trajtim nga skemat e ndihmës ekonomike.

Për periudhën janar – dhjetor 2023, numri i kërkesave dhe ankesave (kartela të qytetarëve) drejtuar kryetares së Kuvendit dhe Kuvendit, është 201 letra. Më konkretisht, tabela nr.2 pasqyron numrin e këtyre letrave për çdo muaj, si më poshtë vijon:

Tabela nr.2

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Letra	10	19	16	18	13	15	12	7	27	33	16	15

- **Pritja e qytetarëve në mjediset e zyrës**

Përgjatë vitit 2023 janë pritur dhe orientuar në Kryesinë e Kuvendit 92 qytetarë. Konkretisht tabela nr.3 pasqyron të dhënat për çdo muaj, si më poshtë vijon:

Tabela nr.3

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Qytetarë	5	10	13	10	2	4	1	1	20	12	10	4

6.2 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Kuvendi krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet, jo më pak se një

herë në muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit¹⁹ (*web-in*) dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e Kuvendit.

6.3. Peticionet

Kuvendi ka ndërmarrë hapa konkretë në zgjidhjen e çështjeve të ngritura në peticione, duke krijuar frymë bashkëpunimi ndërmjet komisioneve përgjegjëse dhe duke ju drejtuar institucioneve publike për veprime të mëtejshme, me qëllim marrjen e informacioneve për gjykim të arsyeshëm të vendimeve. Për vitin 2023, çështjet e trajtuara kanë prekur fusha veprimtarie, si vijon:

- mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve nga ndotja e rëndë që i bëhet zonës rreth fabrikës së çimentos "Cement Factory";
- ndotjen e mjedisit nga ndërhyrjet në të si rrjedhojë e projekteve të infrastrukturës publike, si p.sh. ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës;
- hapjen e zyrave për shërbime pranë godinës së Prokurorisë Mat;
- hapjen e zyrës policore gjyqësore pranë godinës së Prokurorisë Mat;
- rritjen e pagave të pedagogëve.

Gjatë vitit 2023, janë dorëzuar 6 peticione, përkatësisht 3 në muajin prill, 1 në muajin qershor, 1 në muajin tetor dhe 1 në muajin nëntor. Nga këto peticione, katër prej tyre janë trajtuar nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, një peticion u trajtua nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe një tjetër u trajtua nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut.

6.4. Programi i Transparencës - e drejta e publikut për informim

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutë, e cila pas miratimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka krijuar një garanci ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe dokumentacion, për të patur akses në dokumente zyrtare. Në mbështetje të nenit 7, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Kuvendi vijon të publikojë informacion për veprimtarinë e tij parlamentare dhe rishikon e përditëson programin e transparencës, në çdo rast, si të kuadrit ligjor, ashtu edhe të elementeve të tjera që kanë lidhje me transparencën. Nëpërmjet programit të transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, vendoset në dispozicion të qytetarëve një kategori e gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato. Këto modele janë të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe janë të detyrueshme për të gjitha institucionet.

Kuvendi gjatë muajit dhjetor 2023, ka rishikuar dhe përditësuar programin e transparencës, specifikisht kategoritë e informacioneve të detyrueshëm për t'u bërë publike. Programi i transparencës i publikuar në faqen zyrtare *web* të Kuvendit pasqyron informacion të gjerë në interes të publikut në mënyrë që të garantohet dhënia e këtij informacioni pa qenë nevoja për të paraqitur kërkesa.

Ndër kërkesat për informacion të adresuara nga palët e interesuara, të cilat janë trajtuar dhe shqyrtuar nga Kuvendi, bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i përkasin kategorive të renditura si vijon:

- për pagat dhe shpenzimet financiare të deputetëve;

¹⁹ <https://www.parlament.al/struktura/042d8e58-33d1-4697-8fa2-8e3ed2a98098>

- për dosjet personale të kandidatëve të vetingut;
- dokumentacione / procesverbale/ raporte;
- raportimet e KLSH pranë Kuvendit;
- për seancat dëgjimore të zhvilluara nga Komisionet Parlamentare për projektligjin “Për zonat e mbrojtura”;
- për aktivitetin parlamentar dhe udhëtimet e kryetarit/kryetares dhe deputetëve;
- për rregulloren e mbledhjeve të komisioneve parlamentare *online*;
- për dosjet e vitit 1997;
- për deputetin z.Sali Berisha;
- për vendimet e marra nga Këshilli për Rregulloren, Mandatin dhe Imunitetin;
- për ekspertët e jashtëm.

6.5. Koordinimi i punës mbi kërkesat për informacion

Garantimi i së drejtës së informimit dhe bashkërendimi i punës për t'i mundësuar çdo individ të drejtën për t'u njohur me informacion publik, është një nga qëllimet kryesore të Kuvendit. Për këtë arsye, Kuvendi ka ndërmarrë masa për të bashkëpunuar me publikun dhe për të përmirësuar mekanizmat aktualë në plotësimin e kërkesave brenda afateve dhe mënyrës së parashikuar në ligj.

Referuar ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori ka trajtuar 104 kërkesa për informacion për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj.

Gjatë vitit 2023, koordinatori për të Drejtën e Informimit ka administruar një sërë kërkesash për informacion. Konkretisht grafiku nr.21 pasqyron të dhënat për çdo muaj, si më poshtë vijon:

Grafik nr 21. Kërkesa për informacion gjatë vitit 2023



Koordinatori për të Drejtën e Informimit në datë 3.10.2023, ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga organizata Faktoje me temë “E drejta për informim” dhe “Mbrojtja e të dhënave personale”, me qëllim dhënien e informacionit publik për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.

KREU VII

SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut dhe shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe ligjeve është njohur globalisht. Qëllimi kryesor i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare është forcimi i dialogut në dobi të cilësisë së demokracisë me përmbajtje dhe pikëpamje të propozuara nga strukturat e shoqërisë. Rrjedhimisht, shoqëria civile duhet të jetë në gjendje të diktojë procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes me sugjerime, mendime dhe ide. Andaj, duhet të garantohet e drejta e shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes politike.

I prirur nga parimet e pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit, si: ligjshmëria, reciprociteti, transparenca, hapja dhe aksesimi, paaensia, përgjegjshmëria dhe efikasiteti, mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë, Kuvendi ka mundur disa forma dhe mekanizma bashkëpunimi.

Disa nga hapësirat e mundësuar nga Kuvendi për garantimin e bashkëpunimit me publikun, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme për publikun për të garantuar pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse janë:

- publikimi i kalendarit të punimeve dhe aktiviteteve të Kuvendit dhe komisionit përkatës përmes faqes së internetit të Kuvendit, njoftimit në formë të shkruar dhe vizive në media, si dhe nëpërmjet një rrjeti të brendshëm të komunikimit;
- Faqja e internetit e Kuvendit përditësohet rregullisht me informacione në lidhje me punën e Kuvendit dhe komisioneve të tij, duke përfshirë tekstin e projektligjeve të paraqitura, së bashku me arsyetimin e tyre, kalendarin e punës së komisioneve të përhershme dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve, tekstin e amendamenteve të dorëzuara në komisione dhe amendamentet e miratuara, raportet e komisioneve parlamentare që shqyrtojnë projektligjin, procesverbalet e Konferencës së Kryetarëve, komisioneve dhe këshillave, si dhe procesverbalet e seancave plenare;
- regjistrat elektronikë, të cilat ndihmojnë për identifikimin e organizatave jofitimprurëse dhe shërbejnë si instrumente bashkëveprimi me Kuvendin. Regjistri elektronik i OSHC-ve është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare dhe, përditësohet periodikisht, në bazë të kërkesave të organizatave, që shprehin vullnetin e tyre për të qenë pjesë e veprimtarisë së Kuvendit;
- struktura të dedikuara në kuadër të bashkëpunimit me publikun dhe lehtësimin e procedurave të marrjes së informacioneve, sikurse janë koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe koordinatori për Shoqërinë Civile dhe grupet e interesit.

Mekanizmat aktualë të bashkëpunimit janë një tregues i qartë i angazhimit institucional të Kuvendit dhe rolit të tij proaktiv, në drejtim të rritjes së efikasitetit të përdorimit të tyre, por në të njëjtën kohë, edhe përgjegjësi e sfidë, për të shtyrë përpara këtë bashkëpunim, për ta përmirësuar, si dhe për ta pasuruar atë me mekanizma të rinj.

Nëse do të përkthehen në veprime konkrete, për të realizuar me transparencë, objektivat në funksion të përmirësimit të procesit të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe garantimit të një procesi transparence gjithëpërfshirës, sigurimit të hapësirës qytetare të nevojshme, përcaktimit të rregullave të qarta, në mënyrë që të inkurajohet pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, është e

nevojshme dhe domosdoshmëri, që në vijëmbësi, të përcaktohen strukturat dhe mekanizmat, përmes të cilave qytetarët mund të kontribuojnë dhe identifikojnë ata që janë përgjegjës për administrimin e proceseve të angazhimit. Për këtë, Kuvendi duhet:

Së pari, të krijojë një mekanizëm më të qëndrueshëm monitorimi, vlerësimi dhe mësimi, në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe procedurave që rregullojnë bashkëpunimin me OSHC-të.

Së dyti, të forcojë procedurat e tij për dokumentimin dhe shpërndarjen e burimeve të njohurive, mësimëve të nxjerra, praktikave të mira dhe historive të suksesit, duke përfituar nga teknologjitë e avancuara për menaxhimin e njohurive institucionale.

Së treti, të sigurojë që njoftimi paraprak për proceset e konsultimit publik t'u ofrohet të gjitha palëve të interesuara dhe publikut të gjerë në kohë të mjaftueshme dhe të kenë në vend mekanizmat e duhur të reagimit dhe përcjelljes. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje do të jetë e informuar, gjithëpërfshirëse dhe me ndikim domethënës.

Së katërti, të përfshijë në mënyrë proaktive OSHC-të, jo vetëm në njoftimin e projektakteve, por edhe gjatë procesit fillestar të hartimit të akteve përkatëse.

Së pesti, të konsolidojë mekanizmat e reagimit dhe përcjelljes. Kuvendi në procesin e konsultimit me OSHC-të, duhet të krijojë një sistem dhe të përcaktojë një afat kohor për t'ju përgjigjur OSHC-ve dhe qytetarëve për komentet dhe rekomandimet e tyre, duke i njoftuar nëse ato rekomandime janë të përfshira në draftin përfundimtar ose nëse refuzohen, me arsyetimin pse janë refuzuar.

Së gjashti, përdorimi i teknologjive të reja në proceset e konsultimit, të tilla si platformat *online* dhe mjetet elektronike të komunikimit, mund të mbështesin ndërveprimin e zgjeruar, ndërmjet Kuvendit dhe qytetarëve. Ndërsa, njohin potencialin e hapësirave digjitale për të rritur pjesëmarrjen e publikut, roli i tyre në këtë drejtim mund të jetë i pamjaftueshëm dhe të zgjerojë hendekun digjital. Prandaj, është sfidë dhe e nevojshme, të vazhdohet të parashikohet dhe mundësohet pjesëmarrja personale aty ku është e nevojshme.

Së fundmi, format inovative të pjesëmarrjes që shoqërojnë qytetarët drejtpërdrejt, të tilla si proceset e diskutimit dhe bashkëkrijimit në internet, janë praktika premtuese për të mbështetur dhe rinovuar mekanizmat e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse. Ato ndihmojnë në mobilizimin e qytetarëve për të trajtuar problemet komplekse dhe, në këtë frymë, mund të organizohen në formate të ndryshme për të rritur besimin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e publikut. Për këtë duhet:

- të mundësohet pjesëmarrja në fazat e hershme të proceseve të politikëbërjes, në identifikimin e nevojave, prioritetëve dhe përcaktimin e opsioneve të mundshme të politikave, si edhe të sigurojë pjesëmarrjen në tema me interes publik në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt;
- të merren masa për të siguruar, që informacioni t'u ofrohet në mënyrë të dedikuar qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, që ka të ngjarë të preken me një vëmendje të veçantë për individët dhe grupet më të marginalizuara, të nënperfaqësuar dhe më të cenueshme;
- të mundësohet mbështetja dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave publike.

Duke u bazuar në faktin, se vendi ynë e ka shpallur integrimin evropian, si drejtim strategjik për zhvillimin e vendit, të vetëdijshëm për përgjegjësinë që lindin nga autoritetet publike, si dhe nga shoqëria civile, për të ardhmen e vendit dhe shoqërisë sonë, duke e konsideruar mëse të nevojshme përmirësimin e procesit të vendimmarrjes, duke vlerësuar rolin kyç dhe hapësirën e shoqërisë civile

në demokracitë evropiane, duke u nisur nga nevoja për të promovuar demokracinë pjesëmarrëse, duke u nisur nga nevoja, për të institucionalizuar bashkëpunim konkret, ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile në Republikën e Shqipërisë, Kuvendi vlerëson dhe konsideron të rëndësishëm përgjegjësinë e bashkëpunimit me autoritetet publike, shoqërinë civile, grupet e interesit, publikun si dhe organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare.

Andaj, për sa është bërë, mbetet ende për t'u bërë !

Aneksi I

PROJEKTLIGJE NË CILËSINË E KOMISIONIT PËRGJEGJËS

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”
- “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish- ndërmarrjeve bujqësore”
- “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”
- “Një ndryshim në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- “Për qeverisjen elektronike”
- “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”.
- “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin dhe funksionimin e Gjykates Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar.
- "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”
- "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/ 2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar”
- “Për një ndryshim në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar
- “Për disa shtesa në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar”
